



Për: Usmen Baldzi, MASHT – Zëvendës Ministër

Përmes: Bashkim Ibishi, Advancing Together - Drejtor Ekzekutiv

Nga: Genc Broqi, KAAD – Menaxher i Programit

Lënda: Rekomandim për regjistrimin e studenteve ne universitetet publike Udhëzimi Administrativ 09/2016.

I nderuari zëvendës ministër Baldzi,

Organizata jo-qeveritare Advancing Together me programin e sajë Roma Versitas Kosovo Program ka për qëllimi që të rrisë normën e ruajtjes së vijimit dhe kapacitetet akademike të studentëve të universitarë, anëtarë të komunitetit Rom, Ashkali, Egjiptian. Projekti synon të përmirësojë shkallën e vijimit, performancës dhe të diplomimit për student me vijim të rregullt të arsimit universitarë në Kosovë duke iu ofruar aftësi akademike. Ky program financohet nga Roma Education Fund – REF, programi Roma Versitas Kosovo implementohet që nga viti 2013.

PËRFITIMET NGA PROGRAMI

Studentët të cilët do bëhen pjesë e Roma Versitas Kosovo Program do të kenë mundësinë që të aplikojnë dhe të përfitojnë këto shërbime:

- I. Shfrytëzimin e Qendrës së Resurseve, Librarin dhe Librarin Elektronike,
- II. Skemën e Tutor-imit (orë mësimore shtesë për lëndët në të cilat studenti konsideron që ka nevojë),
- III. Për studentët e vitit të parë (brucosh-at) skema e Mentori-mit,
- IV. Shërbimet e zhvillimit Akademik (trajtime profesionale me temat: Shkrim Akademik, Menaxhim i Kohës, Aftësi të Komunikimit dhe Prezantimit, Përgatitje e rezumesë dhe përgatitje për intervistë, aftësi të Debatit dhe Intervistës, Përpilimi dhe Shkrimi i Projekt Propozimeve, Cikli i menaxhimit të projekteve),
- V. Kurse të Gjuhëve Angleze dhe Rome si dhe Kurse të Kompjuterëve,
- VI. Mbështetja Vetë-besimi dhe veprimtaritë sociale,
- VII. Projekte nga iniciativat studentore - SIP(grante te financuara për hulumtime shkencore apo implementimin e projekteve të cilat burojnë nga idetë kreative të studentëve),
- VIII. Punë praktike për përvojë dhe përfitim publik.

Ne si program jemi në kontakte të vazhdueshëm me studentët nga radhët e komuniteteve Roma, Ashkali dhe Egjiptas, ku i ofrojmë shërbimet e lartcekura në tri qendrat tona në Prishtinë, Pejë dhe Prizren, ku gjatë punës tonë me studentë kemi identifikuar nevojat e tyre për regjistrim në universitetit Publike.

Duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 1.6 të ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në republikën e Kosovës (gazeta zyrtare e RKS, Nr. 19, 9 shtator2011), neni 8, paragrafi 1, pika 1.4 të rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Mistrive (Gazeta Zyrtare, Nr. 1, 18 prill 2011), neni 8, paragrafi 11 të ligjit Nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtareve të tyre në RKS, si dhe ne udhëzimin administrative UA Nr. 09/2016 të nënshkruar nga Ministri i Arsimit me datë 03.06.2016,

Ne si organizatë e cila merret me përkrahjen akademike të studentëve nga komunitetet Roma, Ashkali dhe Egjiptas kemi pranuar kërkesa nga studentët që ti përkrahim në regjistrimin ne universitetet publike për vitin akademik 2016/2017. Gjatë kësaj periudhe e kemi përgatitur këtë listë për rekomandimin e studentëve të poshtë cekur që të përkrahen ne regjistrim ne universitetet publike duke u bazuar në UA 09/2016.

1. Lista për regjistrimin e studentëve në universitete publike dokument Annex 1.

Ju lutem te mos hezitoni po qe se keni nevoje për me shume detaje rreth kësaj liste.

Me respekt,

Genc Broqi

